

VENDIM
Nr. 175, datë 26.10.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“HEC-I DRAGOSTUNJE” SHPK, PËR LËNIEN PENG TË ASETEVE TË
LUAJTSHME DHE TË PALUAJTSHME QË DO T’I PËRKASIN “HEC-I
DRAGOSTUNJE” (ASETE QË DO T’I SHËRBEJNË VEPRIMTARISË SË
LICENCUAR; NDËRTEA, PAJISJET DHE GJITHË SISTEMIN E PRODHIMIT DHE
SHPËRNDARJES), NË FAVOR TË BANKËS SOCIETE GENERALE ALBANIA SHA**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, germa “a”, dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në zbatim të neneve 6; 7 dhe 8 të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr.119, datë 21.7.2016; pikave 1.3 dhe 1.6 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, gjithashtu dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.10.2017, mbasi shqyrtoi relacionin mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës se shoqërisë “HEC-i Dragostunje” sh.p.k., për lënien peng të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme që do t’i përkasin “HEC-i Dragostunje”, (asete që do t’i shërbejnë veprimtarisë së licencuar; ndërtesa, pajisjet dhe gjithë sistemin e prodhimit dhe shpërndarjes), në favor të bankës Societe Generale Albania sh.a , të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “HEC-i Dragostunje” sh.p.k plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, gerrat: “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “g”, “j”, “k”, është plotësuar në mënyrë korrekte.
Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 7, pika 1, gerrat “d” (një përshkrim të kandidatit të propozuar për transferim aset, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tri viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare;) dhe “h” (marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e aseteve. Marrëveshja duhet të përmbajë një listë të detajuar të aseteve që kërkohet të transferohen); “i” deklaratë me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit.

- Nenin 7, pika 3 (subjektet konçensionare të licencuara, të cilat aplikojnë për miratimin e transferimit të aseteve në ERE, duhet të shprehin në formë të shkruar, në marrëveshjen e transferimit të aseteve, detyrimet me të cilat ngarkohen për shkak të marrëveshjes së konçensionit e pjesët që transferojnë te përfituesi...), do të njoftohet subjekti që t’i paraqesë në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës se shoqërisë “Hec-i Dragoshtunje” sh.p.k. për lënien peng të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme që do t’i përkasin “Hec-i Dragoshtunje”, (asete që do t’i shërbejnë veprimtarisë së licencuar; ndërtesa, pajisjet dhe gjithë sistemin e prodhimit dhe shpërndarjes) në favor të bankës Societe Generale Albania sh.a.

1. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut do të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti